



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dorezuar Prenheno / Prodato Received / Delivered	16.03.2023	3	vit god year
Organ / Njësia Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kohëzina Quantity
SKIMSHK	2730/2023		1/3



Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.308/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.308/2023 të datës 02.02.2023 të parashtruar nga ankuesi

kundër organit të punësimit/Komuna e Mitrovicës së Jugut, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 16.03.2023, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.308/2023 e datës 02.02.2023 e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Komunën e Mitrovicës së Jugut, me datën 02.02.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 1250/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër përgjigjes me shkrim të datës 18.01.2023 të organit të punësimit/Zyrës së Personelit të Komunës së Mitrovicës së Jugut lidhur me refuzimin e kërkesës së ankuesit për kompensimin e mjeteve financiare në mënyrë retroaktive në emër të diferencës së koeficientit të pagës nga gjashtë (6) në tetë 8, për periudhën nga viti 2015 e tutje.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullosës Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 13.02.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Mitrovicës së Jugut. Ndërsa Këshilli, me datën 02.03.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë nga kjo e fundit së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.



Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova:Ankesën me numër të protokollit 1250/2023 të datës 02.02.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Përgjigjen në kërkesë me numër 01-120/04-0112523-2/22 të datës 18.12.2023 nga Zyra e Personelit në Komunën e Mitrovicës së Jugut; Ndryshimin dhe plotësimin e akt emërimit të ankuesit me numër AE.Nr.01-112/01-0106414/22 të datës 30.11.2022; Formularin e datës 24.09.2012 mbi përshkrimin e detyrave të punës; Akt emërimit të ankuesit me numër 01/112-17728/9 të datës 22.09.2023; Kërkesën e ankuesit me numër 02 Nr.01-120/08-0112523/22 të datës 21.12.2022 lidhur me lidhur me pagesën retroaktive; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 13.02.2023 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 15.03.2023 nga Komuna e Mitrovicës së Jugut lidhur me shkresat e bashkangjitura të lëndës si dhe Vendimin me numër Nr.1-120/04-0105486 të datës 30.11.2022 i nxjerre nga Kryetari i Komunës së Mitrovicës së Jugut.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi se ankesa e ankuesit **është e pabazuar, sepse:**

Kolegji i Këshillit nga provat e administruara të lëndës ka gjetur se ankuesi është i punësuar në Komunën e Mitrovicës së Jugut në pozitën e punës *Inspektor i tregut*. I njëjti me datën 05.10.2022 kishte parashtruar ankesë për harmonizimin e koeficientit të pagës nga gjashtë (6) në koeficientin tetë (8), në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ndërsa ky i fundit me Vendimin A.nr.865/2022 të datës 15.11.2022 ka aprovuar ankesën e ankuesit si të bazuar dhe ka obliguar organin e punësimit që ankuesit t'ia harmonizoj koeficientin e pagës me titullin e pozitës dhe përshkrimin e vendit të punës, nga gjashtë(6) në tetë (8), ku si rrjedhojë organi i punësimit, respektivisht, me datën 25.11.2022, Kryetari i Komunës së Mitrovicës së Jugut ka nxjerrë Vendimin Nr.1-120/04-0105486 sipas të cilit ankuesit i është aprovuar kërkesa për ndryshim të koeficientit nga 6 në 8 dhe me datën 30.11.2022 i është lëshuar akt emërimit sipas koeficientit 8.

Ankuesi me datën 21.12.2022, ka parashtruar kërkesë tek Udhëheqësi i Personelit të Komunës së Mitrovicës së Jugut për kompensimin retroaktiv të diferencës së koeficientit nga viti 2015 e tutje. Udhëheqësi i Personelit të kësaj komunës përmes përgjigjes së datës 18.12.2023 ka refuzuar kërkesën e ankuesit të datës 21.12.2022, me arsyetimin se koeficienti i pagës tetë (8) do të vlejë vetëm nga data e zbatimit të vendimit të Këshillit.

I pakënaqur me përgjigjen e datës 18.01.2023 të organit të punësimit, ankuesi me datën 02.02.2023 parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor për njohjen e të drejtës për kompensimin e diferencës së koeficientit të pagës në mënyrë retroaktive nga hyrja në fuqi e ligjeve të miratuara.

Kolegji i Këshillit, shqyrtoj pretendimin ankimor të ankuesit lidhur me kompensimin e diferencës së koeficientit të pagës në mënyrë retroaktive, dhe si rrjedhojë konstatoi se pretendimi ankimor i ankuesit si i tillë nuk është i bazuar, ngase sipas shkresave të administruara të lëndës rrjedh se ankuesi me datën 22.09.2013 ka nënshkruar aktin e emërimit për pozitën e punës *Inspektor i tregut* me koeficient të pagës gjashtë (6) dhe se i njëjti edhe përkundër faktit se ka qenë në dijeni lidhur me koeficientin e përcaktuar të pagës, nuk ka ndërmarrë asnjë veprim juridik në kuptim të harmonizimit të koeficientit të pagës me vendin e punës deri me datën 21.12.2022, duke vepruar kështu në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.02/L-28 për Procedurën Administrative (ligj ky i aplikueshëm në kohën kur ankuesi kishte nënshkruar aktin e emërimit me datë 22.09.2013),

përkatësisht nenin 130 të këtij ligji ku përcaktohej se: "130.1. Ankimi administrativ bëhet brenda 30 ditësh nga dita kur: a) ankuesi ka marrë njoftim për aktin ose për refuzimin për të nxjerrë aktin", pra në rastin konkretë ankuesi duke mos vepruar konformë legjislacionit që ka qenë në fuqi në këtë kohë ka humbur të drejtën që të kërkoj në mënyrë retroaktive pagesën për diferencën e koeficientit për faktin se tashmë i është ndërruar i njëjti.

Bazuar në at që u tha më lartë e në mbështetje të nenit 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda, A.nr.308/2023, datë 16/03/2023.

Ardita Perçuku-Shyti



Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Mitrovicës së Jugut;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Mitrovicën e Jugut dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

